



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.522/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Jugopromet DOO me seli në Mitrovicën e veriut, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.V., kundër të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditues kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.121/2018 të datës 04.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.121/2018 datës 04.10.2021, Vërtetohet

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke aprovuar si të bazuar Kërkesëpadin e paditësit Jugopromet DOO me seli në Mitrovicën e veriut, ka anuluar Vendimin nr.434/2017 date 15.12.2017 i të paditues ATK-së, dhe Lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe propozon që bazuar në faktet e trajtuara dhe interpretimin e drejtë të dëshmive dhe dispozitave ligjore, të aprovohet ankesa e ATK-së si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.121/2018 datës 04.10.2021, si dhe të mbetet në fuqi vendimi i Departamentit të Ankesave nr.434/2017 dt.15.12.2017. ATK e kundërshton aktgjykimin e atakuar, për arsye se nuk qëndron konstatimi se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues vetëm ka përshkruar gjendjen sipas të gjeturave nga kontrolli, një vlersim i tillë nuk qëndron për faktin se kontrolli ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe nga të gjeturat e kontrollit është vërtetuar se paditësi nuk ka pasur të regjistruara blerjet e kontestuara në libra dhe regjistrime, ashtu siq e parasheh legjislacioni tatimor dhe faturat nuk janë pranuar nga ATK-ja, për faktin se paditësi i ka dorzuar te kontrolli pas draft raportit.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura me Vendimin nr.434/2017 i datës 15.12.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit në procedurë Jugopromet shpk me drejtor Snezhana Kostic, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll, i vërteton si të bazuara.

Kundër këtij aktvendimi përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nga Departamenti për Ankesa të ATK-së, paditësi me padi inicicion konflikt administrativ, në Gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 04.10.2021, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin Aprovon si të bazuar Kërkesëpadinë e paditësit Jugopromet DOO me seli në Mitrovicën e veriut, ka anuluar Vendimin nr.434/2017 date 15.12.2017 i të paditues ATK-së, dhe Lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë, thekson se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye të jaftueshme mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në rishqyrtim. E paditura në arsyetim të vendimit kontestues vetëm ka përshkruar gjendjen sipas të gjeturave nga kontrolli por duke mos dhënë vlersime për faktet dhe provat konkrete. Gjykata në rivendosje e obligon të paditues të trajtoj dhe vlersoj edhe njëher ndryshimet e konstatuara sikurse në të gjeturat nga ekspertiza financiare e datës 09.04.2021 provë e administruar në konflikt administrativ, duke vërtetuar faktet nëse faturat shitëse janë të regjistruara në librat e shitjes-blerjes tek subjekti Tali Shop.

Dhomat e shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102 për ndryshimin dhe Plotsimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar vendimin kontestues të paditues, si dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim rivendosje. Kolegji vlersoi se të metat e gjetura nga gjykata e shkallës së parë në vlersimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar janë të drejta, e cila me të drejtë ka kërkuar nga e

paditura në rivendosje të vërtetohet validiteti i faturave të blerjes nga furnitori Tali Shop për periudhat tatimore 2015-2016, se të njëjtat janë të regjistruara në librat e blerjes-shitjes tek ky subjekt, dhe vetëm mbi bazën e kësaj të sjell vendim meritore.

Pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka konstatuar gjendjen faktike, Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë, i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme këto pretendime, sepse gjatë administrimit të provave në gjykatën e shkallës së parë, dhe provës së siguruar përmes eksertizës financiare datë 09.04.2021, janë nxjerr konstatimet se kompania Tali Shop ka qenë një kompani aktive valide e regjistruar në ARBK dhe në ATK, dhe faturat blerëse janë në përputhshmëri me dispozitat ligjore për llogaritje dhe deklarim të TVSH-së.

Kolegji vlerëson, se gjykata e shkallës së parë me të drejtë është referuar në legjislacionin tatimor dhe administrativ në fuqi, andaj pretendimet e të paditurës në ankesë se, gjykata ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, me rastin e vendosjes dhe nxjerrjes së këtij aktgjykimi ankimor, Kolegji nuk i aprovoi si të drejta.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cënuar ligji në dëm të paditurës, sepse Kolegji, nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura, nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.522/2022 datë 06.07.2023

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,
Krenar Berisha